

Qasja tek të dhënat tuaja

Këshilli i Haringejit mban informata personale mbi rezidentët e vet për një numër arsyesh. Arsyeya kryesore është për të siguruar që ne ju japim shërbime të shpejta dhe efektive. Të gjitha informatat që ne mbajmë mbi ju janë të mbrojtura sipas Aktit të Mbrojtjes së të Dhënave 1998.

Çfarë është Akti i Mbrojtjes së të Dhënave 1998?

Akti i Mbrojtjes së të Dhënave është kornizë ligjore që siguron që informatat tuaja personale përdoren drejt dhe sipas ligjit.

Sipas ligjit, të gjitha organizatat që mbajnë informata mbi ju duhet të ndjekin tetë principet e vëna në Akt. Këto principe sigurojnë që të drejtat tuaja janë të mbrojtura dhe deklarojnë që të gjitha informatat duhet:

- Të përpunohen drejt dhe sipas ligjit dhe vetëm nëse plotësohen kondita të caktuara.
- Të merren për qëllime të specifikuar dhe ligjore.
- Të jenë adekuate, relevante dhe jo të tepërta.
- Të jenë të sakta dhe ku të jetë e duhur të ripërtërihen.
- Të mos mbahen më gjatë se sa duhet.
- Të përpunohen në pajtim me kushtet e të drejtës së të dhënave.
- Të mbahen të sigurta.
- Të mos transferohen jashtë shtetit, përpos në vendet me ligjet adekuate të mbrojtjes së të dhënave.

A më përket mua Akti i Mbrojtjes së të Dhënave?

Po. Akti aplikohet për këdo që mban apo përdor informata për individët. Akti gjithashtu u jep të drejta njerëzve për të cilët bëhet fjalë në informata.

Cilat janë të drejtat e mia sipas Aktit?

Akti u jep një numër të drejtash individëve, që përfshijnë të drejtën tuaj që të keni qasje në të dhënat që mbahen mbi ju, përpos kur lëshimi i këtyre informatave do të shkelte intimitetin e një personi tjetër.

Si mund të gjej se çfarë informatash ju keni mbi mua?

Ju mund të gjeni çfarë informatash kemi mbi ju duke dorëzuar një kërkesë me shkrim tek Zyrtari i Mbrojtjes së të Dhënave. Juve do t'ju duhet të jepni dokumente identifikuese; ne pranojmë kopje të çfarëdo dokumenti ligjor që afishon nënshkrimin tuaj. Ne gjithashtu na duhet të dimë çfarë informate kërkon ju dhe nga cili departament kjo informatë vjen, p.sh. nga Strehimi, Taksat e Këshillit.

Nëse nuk na dërgoni të dhëna të mjaftueshme për të na mundësuar që të gjejmë informatat që ju duhen, ne do t'ju shkruajmë që t'ju sqarojmë se çfarë informatash shtesë na duhen.

Sa kushton kjo?

Këshilli tani për tani jep këtë informacion falas. Megjithatë, një çmim i vogël mund të prezantohet. Ju lutem kontaktoni Zyrtarin e Mbrojtjes së të Dhënave në 020 8489 1997 / 3112 të cilët mund t'ju tregojnë nëse dhe sa ju duhet të paguani.

Çfarë ndodh kur të marrë kërkesën time Këshilli?

Pasi të marrim kërkesën tuaj, ne do t'ju dërgojmë një letër dëftesë të marrjes së kërkesës. Pastaj ne do të mbledhim informacionin e kërkuar dhe to t'ju dërgojmë dokumentet brenda 40 ditësh.

Çfarë nëse nuk jam i kënaqur me informatat që marr?

Kontaktoni Zyrtarin e Mbrojtjes së të Dhënave të Haringejit në 020 8489 1997 / 3112, ose kontakto Zyrën e Komisionarit të Informacionit (shiko më poshtë).

Përpara se të dërgoni kërkesën tuaj për informata, kontrollo që:

- Keni bërë kërkesën me shkrim.
- Të keni identifikuar veten qartë.
- Të keni dhënë informata të mjaftueshme.
- Keni bashkëngjitur pagesën nëse duhet.

Kontakte të dobishme

(Komisionari i Informacionit)

Information Commissioner

Wycliffe House

Water Lane

Wilmslow

Cheshire SK9 5AF

Tel: 01625 545700

Fax: 01625 524510

Email:

mail@dataprotection.gov.uk

Faqja e internetit:

www.dataprotection.gov.uk

(Zyra e Mbrojtjes së të Dhënave)

Data Protection Office

Alexandra House, Level 4

10 Station Road

Wood Green

N22 7TR

Tel: 020 8489 1997 / 3112

Email:

dataprotection@haringey.gov.uk

Faqja e internetit:

www.haringey.gov.uk